

VENDIM
Nr. 367, datë 20.5.2026

**PËR MIRATIMIN E NDËRTIMIT TË CENTRALIT GJENERUES TË
ENERGJISË ELEKTRIKE FOTOVOLTAIKE DHE VEPRAVE NDIHMËSE, I CILI
NUK ËSHTË OBJEKT KONCESIONI, ME VENDNDODHJE NË ZONËN
KADASTRALE 2806, NJËSIA ADMINISTRATIVE SARANDË, BASHKIA
SARANDË, QARKU VLORË, NGA SHOQËRIA “PARK SOL ENERGY” SHPK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:


1. Miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni dhe nuk përfiton nga masat mbështetëse, me vendndodhje në zonën kadastrale 2806, Njësia Administrative Sarandë, Bashkia Sarandë, qarku Vlorë, nga shoqëria “Park Sol Energy” sh.p.k., me elementet e mëposhtme:

- a) Emri i aplikuesit: Shoqëria “Park Sol Energy” sh.p.k.;
- b) NIPT/NUIS: M24603401S;
- c) Tipi i centralit: Fotovoltai;
- ç) Kapaciteti i instaluar: 50 mw;
- d) Afati i pritshëm i vënies në punë dhe pajisja me leje ndërtimi: Koha për ndërtimin, pajisjen me lejen e ndërtimit dhe vënien në operim të impiantit fotovoltaike do të jetë brenda 36 (tridhjetë e gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;
- dh) Vendndodhja e burimit gjenerues të energjisë: në zonën kadastrale 2806, njësia administrative Sarandë, Bashkia Sarandë, qarku Vlorë;
- e) Afati i operimit: 49 (dyzet e nëntë) vjet nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;
- ë) Koordinatat e tokës dhe plan-vendosja, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
- f) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore kanë të drejtë të ushtrojnë mbikëqyrje të përgjithshme me afate 3-mujore gjatë realizimit, vënies në punë dhe operimit, me synim që të verifikojnë se ecuria e punimeve, cilësia, konformiteti dhe operimi janë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit e të dokumentacionit të projektit;
- g) Shoqëria “Park Sol Energy” sh.p.k., ka detyrimin që:
 - i. të paraqesë periodikisht (çdo tre muaj) pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore informacion për ecurinë e ndërtimit të centralit fotovoltaike;
 - ii. të respektojë kushtet e cituara në lejet, licencat dhe autorizimet paraprake mjedisore, lëshuar nga institucionet përgjegjëse kombëtare;
 - iii. të dorëzojë sigurimin e kontratës, në masën jo më pak se 5% të vlerës së investimit, përpara nënshkrimit të kontratës ndërmjet shoqërisë “Park Sol Energy” sh.p.k., dhe ministrisë. Në këtë kontratë përcaktohen të drejtat e detyrimit e palëve për realizimin e këtij projekti, penalitetet, në rast mosrealizimi, si dhe çështje të tjera që lidhen me zbatimin e saj;
 - iv. t’i japë falas, në formë *royalty*, ministrisë përgjegjëse për energjinë, sasinë e energjisë elektrike, në masën 2 (dy) % të sasisë vjetore të prodhimit të energjisë elektrike ose konvertimin e saj në vlerë monetare. Në rast konvertimi në vlerë monetare, shuma duhet të derdhet tërësisht në buxhetin e shtetit;
 - v. të përmbushë kërkesën, sipas rastit, që një pjesë e prodhimit të burimit gjenerues të energjisë t’i shitet furnizuesit publik, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqëria “Park Sol Energy” sh.p.k., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ANEKSI 1



KOORDINATAT NË KRGJSH TË CENTRALIT ELEKTRIK FOTOVOLTAIK "SARANDA 1" 50MW dhe Veprat Ndihmëse					
	E	N		E	N
P1	498419.561	4419414.858	P5	497808.063	4418100.127
P2	498815.671	4418978.482	P6	497945.44	4418502.707
P3	498324.042	4418592.583	P7	498312.053	4419099.756
P4	498304.033	4417820.124	P8	498188.216	4419222.849
KOORDINATAT NË GAUS KRUGER Albanian 1986/GK4 TË CENTRALIT ELEKTRIK FOTOVOLTAIK "SARANDA 1" 50MW dhe Veprat Ndihmëse					
	E	N		E	N
P1	4413042.238	4420041.296	P5	4412415.993	4418733.362
P2	4413433.476	4419600.467	P6	4412557.883	4419134.419
P3	4412937.507	4419220.059	P7	4412931.197	4419727.386
P4	4412908.847	4418447.794	P8	4412808.733	4419851.871